

<b>Fondi i nën-grantimit</b>	150.000 EUR
<b>Numri i granteve</b>	12 grante
<b>Llojet e granteve</b>	Nën-grantet do të zbatohen gjatë një periudhe 6-12 mujore, përkatësisht: <ul style="list-style-type: none"> <li>• 4 nën-grante afatgjata (12 muaj) 10,000-20,000 Euro</li> <li>• 8 nën-grante afatshkurtra (6 muaj) 5,000-10,000 Euro</li> </ul> Kohëzgjatja e projekteve do të varet nga madhësia e nën-granteve si dhe nga fushat prioritare/temat e trajtuara.
<b>Shtrirja kohore</b>	Thirrja për projekt-propozime do të nxirret në Shtator 2018 dhe do të paraprihet nga sesione informimi si edhe publikimin e thirrjes në faqet zyrtare të organizatave (ANTTARC, AFCR dhe AMARO-DROM) Zbatimi i projekteve fituese do të fillojë në Janar 2019.
<b>Aplikantët potencialë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• OSHC-të Rome dhe Egjiptiane</li> <li>• OSHC-të që punojnë me romët dhe egjiptianët</li> <li>• OSHC-të e regjistruara</li> </ul>

### Temat dhe aktivitetet e projekt - propozimeve nxitet të përfshijë:

- Sigurimin e ndihmës juridike, shërbimeve të ndërmjetësimit dhe mentorimit;
- Përmirësimin e legjislacionit për ndihmën juridike për Romët dhe Egjiptianët;
- Rritjen dhe nxitjen e dialogut ndërkulturor;
- Ndërgjegjësimin e komunitetit;
- Pjesëmarrjen e komunitetit;
- Monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve;
- Aktivitete monitoruese; monitorimin e performancës së bashkive, njërive administrative dhe/ ose institucioneve vendore të përqendruara në zbatimin e të drejtave të Romëve dhe Egjiptianëve;
- Monitorimin e shërbimeve të ofruara nga bashkitë dhe institucionet e tjera vendore për romët dhe egjiptianët;
- Pjesëmarrjen e pjesëtarëve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në vendim-marrjen lokale, vendosjen e prioritetëve dhe ofrimin e shërbimeve;
- Mobilizimin e komunitetit për angazhim konstruktiv me institucionet publike për të përmirësuar përgjegjshmërinë e tyre;
- Fushatat e informimit dhe ndërgjegjësimit që fokusohen në të drejtat dhe integrimin komunitetit Rom dhe atij Egjiptian.

## Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Komunitetit Rom

### Financuar nga:



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI

#### Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike

Rruga Reshit Çollaku Pallati Bores Sh. 1 A.20, Tiranë, Shqipëri  
Tel. +355 42247603;  
Fax. +355 42247604  
Email: ngoc@icc-al.org



#### Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri

Rruga Sulejman Pasha, Lagjia 4, Pallati 2, Shk. 3, Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 231 391;  
+355 4 248 925.  
Fax: +355 4 248 925.  
Email: amarodrom@abissnet.al



#### Fondacioni Shqiptar për Zgjidhjen e Konfliktëve dhe Paqëtimin e Mosmarrëveshjeve

Rruga "Him Kolli", Pallati P.F.Trade, Nr.5, Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 44509860  
Cel: +355 692487545  
E-mail: mediationalb@abcmal.al



2018 - 2020



## Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Komunitetit Rom

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Komunitetit Rom" financohet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe zbatohet nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike- ANTARC, në partneritet me Fondacionin "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve - AFCR dhe Unionin për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri- Amaro - Drom.

### Qëllimi

Projekti do të kontribuojë në zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane përmes advokimit për qeverisje të mirë dhe llogaridhënies nga institucionet publike përgjegjëse.

### Objektivi

Objektivi specifik është mbështetja e kapaciteteve të OSHC-ve Rome dhe Egjiptiane për të advokuar për qeverisjen e mirë dhe llogaridhënien për të drejtat e romëve dhe egjiptianëve".

### Kohëzgjatja

30 muaj (Shkurt 2018 - Korrik 2020)

### Buxheti

420,462 EUR

### Rezultatet e pritshme të projektit :

1. OSHC - të Rome dhe Egjiptiane do të rrisin kapacitetet e tyre për të rritur dhe avokuar dhe monitoruar zbatimin e politikave dhe planit të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve.
2. OSHC - të Rome dhe Egjiptiane do të rrisin kapacitetet për pjesëmarrjen e komunitetit, promovimin dhe ofrimin e ndërmjetësimit, si dhe ofrimin e shërbimeve ligjore për komunitetin Rom për të kontribuar në mënyrë kuptimplotë për integrimin e romëve dhe egjiptianëve.
3. OSHC - të Rome dhe Egjiptiane kanë mundësitë dhe kapacitetet për të zhvilluar dhe zbatuar iniciativa për integrimin e romëve dhe egjiptianëve përmes granteve të vogla.

### Përfituesit e projektit ECSORI përfshijnë:

1. 30 Organizata të Shoqërisë Civile Rome dhe Egjiptiane (13 OSHC Rome dhe 17 OSHC Egjiptiane). Këto organizata do të përfitojnë nga programi i rritjes së kapaciteteve e gjithashtu nga komponenti i mbështetjes financiare/nën-grantimit.
2. Organizata të Shoqërisë Civile që ofrojnë shërbime për komunitetet Rome dhe Egjiptiane, do të përfitojnë nga komponenti i mbështetjes financiare/nën-grantimit.
3. Aktivistë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane të cilët nuk kanë kapacitetet e duhura kuptimplotë për të lehtësuar pjesëmarrjen dhe angazhimin aktiv në komunitet, do të përfitojnë nga modeli i mentorimit për zgjidhje problemesh dhe këshillim për grupet Rome e Egjiptiane e gjithashtu nga trajnimi dhe asistencë teknike.
4. Përfaqësues të Qeverisë dhe Institucioneve të tjera vendore në Bashkitë ku jetojnë komunitete Rome dhe Egjiptiane të cilëve do t'u rriten kapacitetet, llogaridhënia dhe ndërgjegjësimi lidhur me implementimin e politikave, Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe bashkëpunimin me aktorë të shoqërisë civile.
5. Anëtarët e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane që do të përfitojnë nga asistencë ligjore, këshillimi dhe ndërmjetësimi, veçanërisht gratë dhe të rinjtë.
6. Anëtarët e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, gjendja e të cilëve në lidhje me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore do të përmirësohet. Përkundër masave të marra për të përmirësuar situatën e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane dhe zbatimin e të drejtave të tyre, ata ende mbeten nga grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare.
7. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve. Projekti do të kontribuojë në zbatimin e këtij Plani.

### Skema e nën-grantimit

Qëllimi i mbështetjes financiare është që OSHC-të që ofrojnë shërbime për komunitetin Rom dhe atë Egjiptian të jenë të afta të zbatojnë projekte e iniciativa që promovojnë të drejtat dhe integrimin e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian në shoqëri.